

DEKLARATË MBI PERSONAT E EKSPOZUAR POLITIKISHT (PEP)

Person i ekspozuar politikisht do të thotë çdo person fizik, vendas ose i huaj, të cilit i është ose u janë besuar poste të larta publike, si:

- President/e, Kryeministër/e, ministër/e, zëvendësministër/e, këshilltar/e politik/e, shef/e i/e kabinetit
- Deputetë të Kuvendit
- Anëtarë/e të organeve drejtuese/qeverisëse të partive politike, në nivel qendror ose lokal
- Anëtarë/e të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës Supreme;
- Ambasadorë/e ose të ngarkuar me punë në përfaqësim të shtetit ose zyrtarë të lartë ushtarakë;
- Kryetarë/e komunash, nënkryetarë/e komunash, drejtorë/e komunalë, këshilltarë/e politikë të kryetarëve dhe nënkryetarëve shefa/e të kabinetit të kryetarëve dhe nënkryetarëve
- Anëtarë/e të listës së partive politike që garojnë në zgjedhjet lokale ose nacionale
- Anëtarë/e të kuvendeve komunale

Personat në njërin prej posteve të cekura më lart konsiderohen PEP nëse tani janë në një post të tillë ose kanë qenë në një post të tillë në një periudhë prej katër (4) vjetësh para datës së paraqitjes së kërkesës për financim në KCSF.

(Për OJQ-të), për të pasur të drejtë për të aplikuar për fonde të KCSF-së, personat e tillë nuk duhet të jenë në pozita udhëheqëse në organizatën jo-qeveritare që aplikon, si:

- Udhëheqës/e i/e Kuvendit të Anëtarëve,
- Udhëheqës/e ose anëtar/e i/e Bordit,
- Drejtor/e ekzekutiv/e,
- Menaxher/e (program ose financa) ose në ndonjë postë të ngjashëm të nivelit të lartë.

(Për nismat e paregjistruara si dhe individë), për të pasur të drejtë për të aplikuar për fonde të KCSF-së që aplikojnë duhet të sigurohen që ata, ose anëtarët e grupit, nuk bëjnë pjesë në njërin prej kategorive të shënuara më lart.

Të gjithë aplikantët kërkohet të deklarojnë gjatë aplikimit në sistemin online nëse ata bien në ndonjërin nga situatat që konsiderohen të papranueshme për shkak të përfshirjes së PEP-ëve në organizatën/nismën e tyre.